

INTERNATIONAL MOBILITY WEEK|ERASMUS DAYS



Gjatë Javës Ndërkombëtare të Mobilitetit, organizuam një seri sesionesh informative të destinuara për të paraqitur procedurat dhe mundësitë për stafin akademik dhe administrativ, si dhe për studentët që janë të interesuar të marrin pjesë në programet e mobilitetit ndërkombëtar dhe programet Erasmus.

Prezantimet theksuan rëndësinë e mobilitetit ndërkombëtar, duke nxjerrë në pah përfitimet për zhvillimin personal dhe profesional. Folësit kryesorë ishin përfaqësues nga institucione të arsimit të lartë në nivel ndërkombëtar. Ky aktivitet ofroi mundësinë për pjesëmarrësit të informohen, të ndajnë përvoja, njohuri dhe të diskutojnë mundësitë e përbashkëta të bashkëpunimit .

Gjithashtu, gjatë sesioneve, u prezantuan praktika të detajuara mbi procedurat institucionale për lehtësimin e studentëve, stafit akademik dhe administrativ, duke siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare. Për studentët, mësuesit,

trajnerët, profesionistët dhe më përgjithësisht, të gjithë qytetarët, #ErasmusDays përfaqësojnë një moment unik për të promovuar shumëllojshmërinë e përfitimeve që rrjedhin nga programi.

Kolegji Universitar Logos